

LËRE ERËN TË FRYJË




Malgosia Bartosik . Philippa Nuttall Jones . Zam Zadeh



2019 do të kujtohet si viti në të cilin diçka ndryshoi, kur fëmijët bënë grevë për të kërkuar që të rriturit të ndërmarrin veprime për të ndaluar ndryshimin e klimës.

I inspiruar nga një bashkëbisedim midis dy mamave (njëra polake mbështetëse erës dhe tjetra një gazetare britanike) dhe një artisti të ri të talentuar iranian, ky libër komik me figura tregon historinë sesi energjitë e rinovueshme si era do të ndihmojnë në transformimin drejt një bote më të pastër e më të shëndetëshme për të gjithë.



Në 2019 fëmijët anë e mbanë botës bënë grevë. Jo sepse nuk u pëlqenin mësuesit e tyre por për t'u thënë të rriturve që duhet të ndërmarrin veprime për të ndaluar ndryshimin e klimës. Ato morën kohë nga koha e tyre në shkollë për të kërkuar të ketë ligje për të mbrojtur Tokën dhe për t'u dhënë atyre një të ardhme të pastër.



Por çfarë është ndryshimi i klimës dhe pse është e rëndësishme të ndalohej?
Për të iu përgjigjur kësaj pyetjeje duhet të kthehemi mbrapa në kohe.
200 vite më parë njerëzit jetonin në fshat.



Pastaj erdhi Revolucioni Industrial.
Fabrikat lulëzuan dhe njerëzit shkuan të jetojnë
në qytete.

Duheshin sasi shumë të mëdha energjie
për të furnizuar këto fabrika dhe më
vonë shtëpitë, makinat dhe aeroplanet.

Përdorimi I makinave për të krijuar produkte në vend që të punohet me dorë
në tokë në përgjithësi do të thotë

Më shumë vende pune



Njerëzit fitojnë më shumë para, mund të blejnë më shumë ushqime,
mund të jetojnë një jetë më të gjatë dhe të shëndetëshme.



Dhe aeroplanet dhe makinat e bëjnë më të lehtë udhëtimin




Por shumë nga këto mundësohen nga djegia e lëndëve djegëse fosile si nafta, qymyri dhe gazi. Këto vine saktësisht nga fosilet, kafshë të vdekura dhe bimë të shtypura në tokë për qindra milionë vjet.

Kur digjen, lëndët djegëse fosile prodhojnë gazra serë si dioksidi i karbonit*.

Një tjetër gaz serë është edhe metani* i cili vjen nga ferma të mëdha me shumë kafshë sidomos lopët, nga gazrat e tyre dhe gromësimat.


*dioksid karboni CO_2

*metan CH_4



Së bashku këto gazra krijojnë një mbulesë të padukshme rreth e rrotull Tokës e cila e pengon ngrrohtësinë e diellit, njësoj si një serë.

Kjo normalisht e bën planetin Tokë një vend të mirë për të jetuar. Por nëse mbulesa bëhet më e trashë kjo shkakton mbingrohje dhe ndryshim të klimës.



Bota është ngrohur me 1°C qëkur u ndërtuan fabrikat e para.

Kjo mund të mos duket shumë. Por njësoj si kur ju ndjeheni keq dhe te ngrohur kur ju rritet temperatura pak, edhe në Tokë gjërat nuk po shkojnë shumë mirë.



Fenomene ekstreme moti si përmbytje ose valë nxehtësie po bëhen më të shpeshta. Kafshët dhe bimët po vuajnë dhe madje edhe po zhduken si pasojë e ndryshimeve në habitatet e tyre.



Dhe njerëzit po semurën dhe po vdesin nga ndotja e ajrit e shkaktuar nga fabrikat dhe makinat.



Ne të gjithë mund të ndërmarrim veprime!



Fikja e dritave kursen energji dhe prodhon më pak dioksid karboni.



Ecja, lëvizja me bicikleta, marrja e autobusit ose trenit krijojnë me pak ndotje sesa të përdorësh makinën ose aeroplanin.



Të hash me pak mish do të thotë më pak metan.



Por kjo nuk mjafton. Djegia e
lëndëve djegëse fosile është shkaku
me I madh I gazrave serë.



Ne duhet të përdorim burime të pastra të
energjisë si dielli ose era në vend të lëndëve
djegëse fosile.



Njerëzit kanë kohë që përdorin energjinë e erës. Përdorimet më të hershme janë varkat me vela për të lëvizur në liqene dhe dete.



Mullinjtë e parë me erë u ndërtuan 2000 vjet më parë për të shpërndarë ujë dhe për të grirë miellin.



Në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shkencëtarë duke përfshirë Poul la Cour, një metereolog nga Danimarka krijuan turbinat e para për të prodhuar energji elektrike.

Në 1918 ishin 120 turbina ere në punë duke prodhuar elektricitet në Danimarkë. Por ishte 1978 viti kur inxhinierët në Danimarkë paraqitën turbinën e erës me tre fletë që inspiroi ato që përdorim sot.



Po si punon një turbinë me erë?



Turbinat e para të erës nuk ishin më të
mëdha sesa kushërinjtë e tyre të shekullit
të nëntëmbëdhjetë.

Turbinat e sotme janë më të
larta, më të mira, lëvizin më
avash, më të forta dhe mund të
jenë në tokë ose në det.

Energjia e prodhuar nga një
rrotullim i turbinave më të
fuqishme të botës mund të fuqizojë
shtëpinë tënde për një ditë.

Në vitin 2025, turbinat e
erës do të jenë më të larta
se kulla Eifel në Paris (secila
prej tyre peshon më shumë
se 100 elefantë!)



Mbi 130,000 turbina ere janë që tani duke ndihmuar të fuqizojnë Europën.
Së bashku me panelet diellore, makinat elektrike, dhe ndryshimet në sjelljen tonë për të kursyer energji dhe për të ndotur më pak, energjia e erës po krijon një të ardhme më të pastër e më të shëndetëshme për të gjithë ne.



Mbeshtetur nga:

Wind[•]
EUROPE

Perkthyer nga:
Lolita Abazi

windeurope.org



www.letthewindblow.org